

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i pergjithshëm, si gjykatë civile e shkallës së parë në trupin gjykues të përbërë nga gjykatësi Faton Bajrami, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët porot Nikolle Kalaj dhe Basri Reqica, në çështjen juridike të paditesit A. B. nga fshati M. e P., Komuna e F. K., te cilin e perfaqeson kujdestari I. B. (gjyshi i tij), kunder te paditurve V. R. nga fshati L., Komuna e F. K., tani me vendbanim ne L., dhe M. B. nga fshati M. e P., Komuna e F. K. duke vendosur për çështjen e vertetimit te amesise dhe atesise, në seancën kryesore jo publike të mbajtur në prani te kujdestarit te paditesit, te paditurit te pare, ndersa ne mungese te paditures se dyte te ftuar me rregulle, ne kuptim te nenit 112 te LPK-se, me dt. 15.11.2017, mori dhe shpalli, këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET ne tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. B. nga fshati M. e P., Komuna e F. K., i lindur me daten *data e lindjes...*, dhe **VERTETOHET** se e paditura V. S. R. nga fshati L., Komuna e F. K., tani me vendbanim ne L., eshte e ema biologjike dhe i padituri M. I. B. nga fshati M. e P., Komuna e F. K. eshte babai biologjik i paditësit A. B., i lindur nga bashkësia jashtë martesore ne mes te paditurve.

II. Ne baze te ketij aktgjykimi Komuna e Fushe Kosoves–Zyra e Ofiqarise do te beje regjistrimin e paditësit ne librin amze te te lindurve, ku do te vërtetohet sea paditësi A. B. eshte i biri i M. B. dhe V. R..

III. Secila pale i barte shpenzimet e veta te proceduers kontestimore.

Arsyetim

Fillimisht pran kësaj gjykate ishte ushtruar padi per besimin e femiut, e ku si paditës ishte M. B. ndërsa e paditur V. R., mirëpo gjykata me te konstatuar se femiu, besimi i te cilit kërkohej nuk ishte i regjistruar ne librat ame te te lindurve, njoftoi palet e pranishme, e pas kësaj eshte bere ndryshimi i padisë ne kuptimin subjektiv dhe objektiv.

Paditësi A. B. nëpërmjet te kujdestarit te tij I. B. e i cili eshte gjyshi i tij (i caktuar me aktvendim te Organit te Kujdestarise), ka deklaruar se mbetet ne tersi pran padisë se ushtruar me date 29.09.2017 dhe korrigjimit- precizimit te bere ne proqesverbalin e seancës se dates 20.10.2017, duke i propozuar gjykates qe te aprovohet ne tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. B. nga fshati M. e P., Komuna e F. K., i lindur me daten *data e lindjes...*, dhe vërtetohet se V. S. R. nga fshati L., Komuna e F. K., tani me vendbanim ne L., eshte e ema biologjike dhe i padituri M. I. B. nga fshati M. e P., Komuna e F. K. eshte babai biologjik i paditësit A. B., i lindur nga bashkësia jashtë martesore ne mes te paditurve.

Po ashtu i ka propozuar gjykates qe ky aktgjykim te shërbej si dokument me te cilin detyrohet organi kompentet Zyrja e gjendjes civile ne Fushe Kosove te beje evidentimin e paditësit ne librat përkatës si femi biologjik i lindur nga bashkesia jashtemartesorë ne mes te paditurve M. B. dhe V. R..

Shpenzimet e procedurës nuk i kerkoi.

E paditura V. R. edhe pse e ftuar ne menyre te rregullte qe nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor ne kete çështje juridiko civile e ku eshte ftuar qe te jap përgjigje ne padi si dhe te prezantoi ne seancat e mbajtura, e njëjta ka refuzuar pranimin e ftesave ne seance, e ku refuzimi eshte konstatuar ne fletekthesat, duke kërkuar qe gjykata te mos komunikoi me me te. E paditura ne asnjë forme nuk ka pohuar apo mohuar kërkesëpadinë e palës paditese, mirëpo vetëm ka refuzuar ftesat, pa ndonjë arsytim.

I padituri M. B. ne deklarimet e tij qe nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor e po ashtu edhe ne fjalën perfundimtare ka pohuar ne tersi kërkesëpadinë e birit te tij, tani paditësit duke pohuar se A. ka lindur nga bashkësia jashtë martesore ne mes te paditurve mirëpo i njëjti nuk eshte evidentuar ne librat e gjendjes civile, fillimisht pas lindjes per shkaqet neglizhente, pa ndonjë arsye te veqant, deri sa nderkoh pas disa viteve raportet jashtë martesore ne mes te tani te paditurve janë keqësuar, ku e paditura V. eshte larguar nga shtëpia, eshte martuar ne nje familje tjetër dhe ka shkëputur çdo komunikim me mua dhe djalin A.. I padituri ka ritheksuar se arsyeja e mos regjistrimit te femiut A. B. si femije i këtu te paditurve ka qëndruar ne neglizhence te paditurve, nuk përmban arsye parimore, nuk ka asnjë baze per te dyshuar se ky femije eshte femi i te paditurve.

I ka propozuar gjykates qe kërkesëpadia e paditësit te aprovohet ne tersi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i kerkoi.

Gjykata për të vendosur drejtë në këte çështje kontestimore në procedurën e provave administroi provat me leximin - shiqimin ne aktendimin mbi caktimin e kujdestarit te perkohshem lëshuar nga QPS ne Fushe Kosove nr. 665/17 date 28.08.2017, me shiqimin – leximin e deklaratës se dhene nga dëshmitari (tani kujdestari i paditësit) I. B. ne seancën e dates 06.07.2017, fleteleshimin e lëshuar nga QKUK Klinika Opstretrike Gjinekologjike me nr. te amzës 4286 ne emër te V. S. R., kartonin e posalindurit date *data e lindjes...*, parashtresën drejtuar kësaj gjykate nga SHSKUK Klinika e gjinekologjisë me nr. te protokolit 1752/2 date 22.06.2017, anamnezën e QPS ne Fushe Kosove nr. 838 date 01.10.2015, parashtresën e lëshuar nga QPS Lipjan date 31.05.2017, dokumentacionin mjekësor ne emër te paditësit.

Provat e administruara gjykata i vlersoi te gjitha nje nga nje dhe ne varesi me njera tjetren ne veshtrim te nenit te 8 te Ligjit per Proceduren Kontestimore, dhe ate:

- Nga aktvendimi mbi caktimin e kujdestarit te perkohshem i dates 28.08.2017, gjykata konstaton se sipas kërkesës se kësaj gjykate Qendra per pune Sociale ne Fushe Kosove, tani femiut A. B. i ka caktuar kujdestarin e perkohshem, me cilësi te përfaqësuesit ligjor, me qellim te përfaqësimit ne kete çështje juridiko civile. Per kujdestar eshte caktuar gjyshi i tij I. B..

-Nga fleteleshimi me epikrize me nr. te amzës dhe kartelës 4286, i lëshuar nga Qendra QKUK Klinika e gjinekologjise ne emër te tani te paditurës V. S. R., per kohen e qëndrimit ne spital nga data 29.03.2004 deri ne datën *data e lëshimit...*, gjykata konstaton se tani e paditura me date *data e lindjes...*, rreth orës 20.25 min ka linde femije, te gjalle te gjinisë mashkullore, me peshe 3950/56, ne repartin e kësaj klinike.

-Nga kartoni i posalindurit, i lëshuar nga QKUK, Klinika opstetrike, ne emër te V. R., gjykata konstaton se tani e paditura ka linde femije te gjinisë mashkullore me date *data e lindjes...*.

- Nga parashtresa e date 27.06.2017 - përgjigja e Sherbimit spitalor klinik i R. te Kosoves, e cila përgjigje eshte dhene sipas kërkesës se kësaj gjykate, kjo gjykate konstaton se ky Institucion, përmes kësaj parashtrese, ka njoftuar gjykatën se tani e paditura V. R. nga fshati L. Komuna e F. K. e lindur ne vitin viti i lindjes..., me bashkëshort M. B., ka linde femije me date *data e lindjes...*, rreth orës 20.25 min. te gjinisë mashkullore me peshe 3950/56.

-Nga raporti- anamneza e Qendres per pune Sociale ne Fushe Kosove, nr. protokoli 838, date 01 Tetor 2015 gjykata konstaton se sipas kërkesës se kësaj gjykate eshte hartuar kjo anamneze sociale nga e cila rezulton se, sipas deklaratës se tani te paditurit M. B., rezulton se tani qe te dy te paditurit janë martuar ne vitin 2003, kane lindur nje djalë A. B. i mirëpo diku ne vitin 2009 filluan mosmarrëveshjet ne mes tyre, te cilat rezultuan ne ndarje. Sipas mendimit te kësaj qendre femiu duhet ti besohet babait, duke qene se babai me familjen e tij janë ne përkujdesje te femiut.

-Nga parashtresa e QPS ne Lipjan, përkatësisht përgjigja e këtij Institucioni sipas kërkesës se kësaj gjykate, rezulton se QPS ne Lipjan, ka kontaktuar tani te paditurën V. R., e ka njoftuar rreth këtij kontesti. Mirepo tani e paditura ka refuzuar te jap çfardo lloj deklarate apo informate lidhur me kete kontest me arsyetimin se ne kohen kur e paditura ka dashur te regjistroi djalin, ish bashkëshorti i saj nuk ka pranuar dhe nuk eshte interesuar rreth kësaj çeshtje. Po ashtu ka kërkuar qe tani e tutje te mos pengohet dhe shqetësohet lidhur me kete kontest.

-Nga deklarata e dëshmitarit I. B., i cili eshte gjyshi i femiut, (po ashtu i cili gjate këtij shqyrtimi gjyqësor ka marre statusin e kujdestarit te femiut per përfaqësim ne kete çeshtje juridiko civile) dhene ne proqesverbalin e seancës se dates 06.07.2017, rezulton se ky deshmitare eshte babai i M. B., ku nga dëshmia e tij rezulton se i biri i tij M. eshte martuar diku ne vitin 2003 me V. R. edhe pse miqësia ne mes familjes B. dhe familjes R. ka datuar qysh me herët, 30 vite me pare. Deshmitari ne deshmin e tij ka sqaruar se raporti jashte martesor ne mes te M. dhe V. ka zgjatur disa vite dhe gjate kohës se këtij raporti ka lindur nje femije A. B. i cili ka lindur ne vitin e dyte te ekzistimit te kësaj martese. Deshmitari po ashtu ka sqaruar se gjate kohës se ekzistimit te bashkësisë jashtë martesore asnjëherë nuk ka pasur kontest rreth amësisë dhe atësisë se femiut, mirëpo pas zgjidhjes se martesës sipas këtij dëshmitari, tani e paditura V. R. ka theksuar se nuk do te mbaj kontakte me te birin e saj A. B..

Gjykata pasi analizoi provat e administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-se vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është ne tersi e bazuar, dhe atë në bazë të gjendjes faktike gjykata vërtetoi se e paditura V. S. R. nga fshati L., Komuna e F. K., tani me vendbanim ne L., eshte e ema biologjike dhe i padituri M. I. B. nga fshati M. e P., Komuna e F. K. eshte babai biologjik i paditësit A. B., i lindur nga bashkësia jashtë martesore ne mes te paditurve. Kete gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga provat e administruara, me sakte fleteleshimi i Klinikës gjinekologjike rezulton se tani e paditura V. R. me date *data e lindjes...*ka lindur femije te gjinisë mashkullore, e ku nga te dhënat e kësaj klinike si ne pergjigjen e dates 22.06.2017 rezulton se bashkëshorti i saj ka qene M. B., kete fakt e vërteton edhe deklarata e V. R. e dhene pran Qendres per pune Sociale ne F. K. si ne anamnezën e datës 01. Tetor 2015, e po ashtu edhe deklarata e dëshmitarit I. B. i cili ne deshmin e tije ka rrethksuar se gjate ekzistimit te këtij raporti jashtë martesore ne mes te tani te paditurve nuk ka pas kontest lidhur me amësinë apo atësinë e femiut. Po ashtu gjykata konstaton se tani i padituri M. B. gjate gjithë shqyrtimit kryesor ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit, përkatësisht ka pohuar faktin se eshte babai i femiut A. B.. Mbi kete baze, gjykata ne kuptim te nenit 99, 101 dhe 112 te Ligjit per Familjen i Kosoves,

Ne baze te nenit 450 te LPK gjykata vendosi qe secila pale te i barte shpenzimet e veta te procedures.

Me sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E THMELORE NË PRISHTINË
C.nr.2398/14 dt.15.11.2017

Kryetari i trupit gjykues –gjykatësi
Faton Bajrami

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij, Gjykatës se Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.